



BASHKIA KOLONJË

**Rregullore e Integruar për Organizimin dhe
Funksionimin e Sistemit të Menaxhimit Strategjik,
Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Mekanizmave të
Integritetit dhe Antikorrupsionit në Bashkinë Kolonjë**

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i Rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit strategjik, kontrollit të brendshëm financiar, menaxhimit të riskut, auditimit të brendshëm, si dhe të mekanizmave për forcimin e integritetit institucional dhe parandalimin e korrupsionit në Bashkinë Kolonjë.
2. Kjo rregullore synon vendosjen e një kuadri të unifikuar administrativ dhe funksional, që garanton përdorimin me përgjegjësi, efikasitet dhe transparencë të burimeve publike, si dhe forcimin e llogaridhënies dhe mbrojtjes së interesit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet në të gjitha Drejtoritë, Sektorët dhe Njësitë Administrative që funksionojnë nën juridiksionin e Bashkisë Kolonjë dhe që përdorin, menaxhojnë ose administrojnë fonde publike.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për drejtuesit e Drejtorive, Sektorëve dhe Njësive Administrative të Bashkisë Kolonjë, grupet e menaxhimit strategjik, Njësinë e Auditit të Brendshëm, si dhe për të gjitha strukturat dhe personat që marrin pjesë në proceset e planifikimit, kontrollit, menaxhimit të riskut dhe raportimit financiar brenda institucionit.

Neni 3

Baza ligjore

1. Kjo rregullore mbështetet në dispozitat e legjislacionit në fuqi që rregullon fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimit të brendshëm, vetëqeverisjes vendore dhe masave për garantimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:
 - a) Ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (*i ndryshuar*);
 - b) Ligjin Nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (*i ndryshuar*);
 - c) Ligjin Nr.114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*i ndryshuar*);
 - d) Ligjin Nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
 - e) Ligji Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (*i ndryshuar*);
 - f) Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (*i ndryshuar*).

Neni 4

Parimet e përgjithshme

Organizimi dhe funksionimi i sistemit të integruar të menaxhimit strategjik, kontrollit të brendshëm financiar dhe mekanizmave të integritetit dhe antikorrupsionit në Bashkinë Kolonjë mbështetet në parimet themelore të mëposhtme, të cilat udhëheqin çdo veprim institucional dhe procedurë administrative:

- a) Parimi i ligjshmërisë;
- b) Parimi i transparencës;
- c) Parimi i përgjegjshmërisë institucionale;
- d) Parimi i integritetit;
- e) Parimi i efikasitetit, efektivitetit dhe eficientësisë;
- f) Parimi i menaxhimit të riskut;
- g) Parimi i parandalimit të korrupsionit;
- h) Parimi i pavarësisë funksionale të auditimit të brendshëm.

Neni 5

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termat dhe shprehjet e mëposhtme do të kuptohen në mënyrën e përcaktuar si më poshtë:

1. “Menaxhimi strategjik” është procesi i planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit të veprimtarive të bashkisë, i cili ka për qëllim përcaktimin e objektivave afatgjata zhvillimore, zhvillimin e strategjive për arritjen e tyre dhe përdorimin efektiv të burimeve publike, në përputhje me nevojat e komunitetit dhe legjislacionin në fuqi.
2. “Kontrolli i brendshëm financiar” është një sistem i organizuar i procedurave, politikave dhe masave që zbatohen brenda Bashkisë, me qëllim sigurimin e menaxhimit efektiv dhe eficient të burimeve financiare, mbrojtjen e pasurisë, përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe garantimin e saktësisë dhe plotësisë së informacionit financiar i cili përfshin verifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë financiare në mënyrë që të parandalohet keqpërdorimi, korrupsioni dhe gabimet si dhe të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia financiare.
3. “Auditimi i brendshëm” është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.
4. “Integritet” është parimi themelor i veprimit etik dhe ligjor të punonjësve dhe drejtuesve të Bashkisë, i cili shpreh përmbushjen e detyrave me ndershmëri, drejtësi, paanshmëri dhe përpikëri, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe standardet profesionale që rregullojnë administratën publike.
5. “Mekanizma antikorrupsion” janë një grup masash, procedurash dhe instrumentesh ligjore, administrative dhe institucionale, të përcaktuara për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar veprimet korruptive.
6. “Risk” është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të njësisë.
7. “Procedura antikorrupsion” janë një sërë hapash të organizuar dhe të detajuara, të përcaktuara me ligj dhe rregullore, të cilat synojnë parandalimin, zbulimin, trajtimin dhe ndëshkimin e veprimeve korruptive.

8. "Linja e raportimit" është është kanali formal dhe i strukturuar hierarkik sipas kuadrit rregullator në fuqi brenda Bashkisë përmes të cilit informacionet, sinjalizimet dhe dokumentet depozitohen, shqyrtohen dhe miratohen nga nivelet përkatëse të menaxhimit dhe autoriteteve kompetente, në përputhje me rendin dhe autorizimet e përcaktuara nga rregulloret dhe procedurat e brendshme të institucionit.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT STRATEGJIK

Neni 6

Qëllimi dhe Objektivat e Sistemit të Menaxhimit Strategjik

1. Sistemi i menaxhimit strategjik ka për qëllim përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, planeve dhe objektivave strategjike të Bashkisë, me qëllim sigurimin e përdorimit efektiv, efikas, ekonomik dhe transparent të burimeve publike.
2. Ky sistem synon të garantojë realizimin e misionit dhe vizionit të Bashkisë në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë institucionale dhe integritetit, duke siguruar ushtrimin e funksioneve publike me standarde të larta etike dhe profesionale.

Neni 7

Përbërja dhe Strukturimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik

1. Në Bashki ngrihet dhe funksionon Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili përbëhet nga drejtuesit kryesorë të strukturave organizative, përkatësisht drejtorët dhe përgjegjësat si dhe anëtarë të tjerë të përcaktuar me akt administrativ të Titullarit të Njesisë.
2. Grupi i Menaxhimit Strategjik ka për detyrë koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planeve strategjike dhe vjetore të Bashkisë.
3. Struktura, funksionimi dhe mënyra e emërimit të anëtarëve të grupit rregullohen me akt të veçantë të titullarit të njesisë publike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 8

Hartimi, Miratimi dhe Përditësimi i Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Veprimit

1. Bashkia harton dhe miraton Planin Strategjik Afatmesëm, në të cilin përcaktohen objektivat kryesore, burimet e nevojshme dhe aktivitetet për realizimin e tyre.
2. Plani Strategjik përditësohet periodikisht, sipas kërkesave dhe ndryshimeve në mjedisin ligjor, ekonomik dhe social.
3. Përveç Planit Strategjik, hartohet dhe miratohet Plani Vjetor i Veprimit, i cili specifikon aktivitetet konkrete dhe indikatorët e matshëm të performancës për secilin vit.
4. Planet hartohen dhe miratohen në përputhje me kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore për vetëqeverisjen vendore dhe menaxhimin financiar.

Neni 9

Detyrat e Grupit të Menaxhimit Strategjik

1. Grupi i Menaxhimit Strategjik harton rekomandime për politikën strategjike të njësisë publike dhe propozon ndryshime të nevojshme në planet strategjike dhe ato vjetore.
2. Ai monitoron zbatimin e planeve dhe i raporton periodikisht titullarit të njësisë publike progresin dhe vështirësitë e konstatuara.
3. Grupi analizon riskun strategjik dhe propozon masa për parandalimin dhe trajtimin e tij.
4. Ai bashkëpunon ngushtë me Njësinë e Auditit të Brendshëm për verifikimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit strategjik.

Neni 10

Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi në Menaxhimin Strategjik

1. Bashkia zhvillon mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në kuadër të Planit Strategjik dhe atij Vjetor.
2. Rezultatet e monitorimit i raportohen në mënyrë të rregullt dhe transparente titullarit të njësisë publike dhe organeve mbikëqyrëse sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në bazë të raportimeve, miratohen masa për përmirësimin e performancës dhe përballimin e risqeve operative dhe strategjike.

Neni 11

Mjetet e Teknologjisë së Informacionit në Mbështetje të Menaxhimit Strategjik

1. Bashkia, në funksion të garantimit të një procesi të strukturuar dhe të verifikueshëm të menaxhimit strategjik, përdor mjete dhe sisteme të teknologjisë së informacionit, përfshirë platformat digjitale dhe programet elektronike për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave strategjike.
2. Përdorimi i teknologjisë synon të rrisë transparencën, efikasitetin, shpejtësinë dhe saktësinë e proceseve vendimmarrëse dhe monitoruese në zbatimin e objektivave strategjike.
3. Bashkia ka detyrimin të publikojë në mënyrë të rregullt dhe të përditësuar, në faqen zyrtare të saj, çdo informacion të konsideruar me rëndësi për publikun, që lidhet me politikën, planet strategjike, indikatorët e performancës dhe raportet e progresit, në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe transparencën në qeverisje.

KAPITULLI III

SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR

Neni 12

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm Financiar

1. Sistemi i kontrollit të brendshëm financiar përbën një kuadër të integruar politikash, procedurash dhe mekanizmash, që siguron ligjshmëri, transparencë dhe integritet në administrimin e burimeve financiare të Bashkisë.
2. Sistemi synon të mundësojë identifikimin, parashikimin, vlerësimin dhe adresimin në kohë të risqeve që lidhen me proceset financiare dhe operacionale, duke përfshirë

- edhe parandalimin e gabimeve materiale, devijimeve procedurale, mashtrimeve financiare, keqadministrimeve dhe formave të tjera të abuzimit me fondet publike.
3. Sistemi hartohet, zbatohet dhe rishikohet periodikisht në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet profesionale dhe udhëzimet e ministrit përgjegjës për financat.

Neni 13

Funksionet Thelbësore të Kontrollit të Brendshëm Financiar

1. Kontrolli i brendshëm financiar mbështetet mbi tri shtylla funksionale:
 - a) menaxhimi financiar dhe kontrolli;
 - b) auditimi i brendshëm;
 - c) menaxhimi i riskut.
2. Këto shtylla veprojnë në mënyrë të ndërruar, por të ndara funksionalisht, duke kontribuar në garantimin e qeverisjes së mirë, eficiencës operacionale dhe respektimit të rregullave financiare në nivel institucional.

Neni 14

Dokumentacioni dhe Raportimi Financiar

1. Njësia publike ka detyrimin ligjor të sigurojë krijimin dhe mirëfunksionimin e një sistemi të konsoliduar dokumentimi financiar, i cili garanton gjurmueshmërinë, saktësinë dhe integritetin e të gjitha transaksioneve buxhetore e jashtëbuxhetore, në përputhje me normat e legjislacionit përkatës në fuqi.
2. Dokumentacioni financiar përfshin regjistrimet kontabël, aktet shoqëruese, evidencat mbështetëse dhe çdo informacion tjetër që pasqyron e justifikon veprimtarinë financiare të bashkisë dhe ruhet sipas kërkesave të legjislacionit përkatës në fuqi.
3. Raportet financiare hartohen në mënyrë të standardizuar, transparente dhe objektive, duke respektuar format dhe afatet e përcaktuara nga kuadri ligjor që rregullon menaxhimin financiar publik.
4. Raportet u paraqiten autoriteteve mbikëqyrëse dhe auditimit të jashtëm dhe duhet të jenë të qarta, të matshme, të verifikueshme dhe të pasqyrojnë në mënyrë të paanshme gjendjen reale financiare të bashkisë, duke përmbushur standardet e transparencës, llogaridhënies dhe besueshmërisë institucionale ndaj publikut dhe organeve kompetente.

Neni 15

Linjat e Përgjegjësisë dhe Raportimit

1. Çdo drejtues njësie strukturore brenda Bashkisë është përgjegjës për zbatimin e masave të kontrollit të brendshëm në fushën e veprimtarisë që mbulon, dhe raporton periodikisht mbi ecurinë e zbatimit.

Neni 16

Vlerësimi dhe Rishikimi i Sistemit të Kontrollit

1. Bashkia organizon të paktën një herë në vit, vlerësimin e brendshëm të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.
2. Vlerësimi përfshin analizën e risqeve, përputhshmërinë me objektivat institucionale dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

3. Rezultatet e vlerësimit dokumentohen dhe përbëjnë bazë për rishikimin e masave, procedurave dhe strukturave përkatëse.

Neni 17

Publikimi i Informacionit mbi Kontrollin e Brendshëm

1. Bashkia ka detyrimin të publikojë në faqen zyrtare të saj, në mënyrë periodike, informacion për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar, duke përfshirë të dhëna për:
 - a) Strukturat përgjegjëse;
 - b) Politikat e zbatuara;
 - c) Raportet përmbledhëse të auditimit të brendshëm;
 - d) Masat e marra për adresimin e risqeve dhe rekomandimeve.
2. Publikimi kryhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI IV

FUNKSIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Neni 18

Statusi dhe Pavarësia e Njesisë së Auditit të Brendshëm

1. Funkzioni i auditimit të brendshëm ushtrohet në mënyrë të pavarur, objektive dhe të paanshme, në përputhje me parimet dhe standardet e njohura profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik.
2. Audituesi i Brendshëm gëzon pavarësi funksionale dhe organizative në kryerjen e detyrave të tij, duke qenë i lirë nga çdo ndërhyrje, ndikim apo presion nga autoritetet ekzekutive, politike ose administrative të njesisë publike.
3. Njësia e Auditit të Brendshëm raporton drejtpërdrejt tek titullari i njesisë publike, si dhe, kur parashikohet me ligj, tek organet mbikëqyrëse përkatëse.

Neni 19

Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Njesisë së Auditit të Brendshëm

1. Auditimi i brendshëm ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, objektive dhe të paanshme, duke vlerësuar:
 - a) Mjaftueshmërinë dhe funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në raport me objektivat institucionale dhe menaxheriale të njesisë publike;
 - b) Efektivitetin dhe efikasitetin e procesit të menaxhimit të riskut, përmes identifikimit, analizës dhe vlerësimit të risqeve që mund të ndikojnë në integritetin financiar dhe operacional të institucionit;
 - c) Përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Neni 20
Planifikimi dhe Zbatimi i Auditimeve

1. Njësia e Auditit të Brendshëm harton Planin Strategjik dhe Vjetor të auditimeve, bazuar në vlerësimin e risqeve dhe objektivave të institucionit, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për financat dhe standardet profesionale përkatëse.
2. Plani Strategjik dhe Vjetor i auditimit miratohet nga Kryetari i Bashkisë dhe zbatimi i tij i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhdueshme.

Neni 21
Raportimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm

1. Në përfundim të angazhim-auditimeve, Njësia e Auditit të Brendshëm harton Raportin Përfundimtar të Auditimit.
2. Raporti Përfundimtar i Auditimit i dorëzohet titullarit të njësisë publike dhe subjektit të audituar dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në përputhje me legjislacionin për transparencën dhe të drejtën për informim.
3. Njësia e Auditit të Brendshëm ndjek zbatimin e rekomandimeve dhe kërkon nga subjektet e audituara raportim mbi progresin.
4. Njëherë në vit, Njësia e Auditit të Brendshëm përgatit Raportin Vjetor të veprimtarisë së auditimit, i cili i dorëzohet Titullarit të Institucionit dhe i përcillet Ministrisë së Financave, në përputhje me afatet dhe formatin e përcaktuar në udhëzimet përkatëse.

KAPITULLI V
MENAXHIMI I RISKUT

Neni 22
Strategjia e Menaxhimit të Riskut

1. Bashkia miraton Strategjinë e Menaxhimit të Riskut, e cila përcakton parimet, qasjen, përgjegjësitë dhe metodologjitë për administrimin e risqeve që cenojnë arritjen e objektivave strategjike, operacionale dhe financiare.
2. Strategjia e Menaxhimit të Riskut hartohet në përputhje me legjislacionin për menaxhimin financiar publik, standardet kombëtare dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e riskut në sektorin publik.

Neni 23
Procesi i Menaxhimit të Riskut

1. Menaxhimi i riskut zhvillohet në këto faza:
 - a) Identifikimi i risqeve;
 - b) Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes dhe ndikimit të tyre;
 - c) Zgjedhja dhe zbatimi i masave për trajtim duke hartuar Regjistrin e Riskut;
 - d) Monitorimi dhe rishikimi i vazhdueshëm periodik 2 herë në vit.
2. Për zbatimin e këtij procesi, Bashkia ngre Grupin e Menaxhimit të Riskut, i cili koordinon, dokumenton dhe raporton mbi risqet dhe masat përkatëse tek Titullari i Njesisë.

Neni 24

Përgjegjësitë e Drejtorëve dhe Përgjegjësve të Sektorëve në Menaxhimin e Riskut

1. Drejtorët dhe Përgjegjësat e Sektorëve kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve në fushat e tyre të veprimtarisë.
2. Ata duhet të sigurojnë zbatimin e masave parandaluese dhe të raportojnë periodikisht tek Grupi i Menaxhimit të Riskut për fushat me risk më të lartë.

Neni 25

Raportimi dhe Bashkërendimi me Auditin e Brendshëm

1. Grupi i menaxhimit të riskut paraqet periodikisht raporte tek Titullari i Institucionit, të cilat përmbajnë vlerësimin e gjendjes aktuale të riskut, masat parandaluese dhe sugjerimet për përmirësim.
2. Funkzioni i kontrollit të brendshëm financiar bashkëpunon ngushtësisht me strukturat e menaxhimit të riskut, për të verifikuar zbatimin e masave dhe për të siguruar që risqet të adresohen në mënyrë efektive dhe në kohë.

Neni 26

Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale për Menaxhimin e Riskut

1. Bashkia siguron ngritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të personelit përgjegjës për menaxhimin e riskut, nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe asistencës teknike.

KAPITULLI VI

MEKANIZMAT E INTEGRITETIT DHE ANTIKORRUPSIONIT

Neni 27

Parimet dhe Objektivat Themelore të Integritetit dhe Parandalimit të Korrupsionit

1. Bashkia, në ushtrim të funksioneve të saj publike, respekton dhe promovon parimet e integritetit, transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit institucional.
2. Qëllimi kryesor i mekanizmave të integritetit është parandalimi, evidentimi dhe ndëshkimi i çfarëdo forme sjelljeje të paligjshme apo korruptive në veprimtarinë administrative, financiare apo vendimmarrëse të Bashkisë.

Neni 28

Masat Institucionale për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit

1. Bashkia zbaton masa të detyrueshme për:
 - a) Deklarimin e pasurisë dhe interesave private;
 - b) Menaxhimin e konfliktit të interesit;
 - c) Trajnimin e stafit për etikën dhe integritetin;
 - ç) Sinjalizimin dhe trajtimin e shkeljeve.
2. Përgjegjësitë për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtyre masave përcaktohen në aktet e brendshme, në përputhje me ligjin.

Neni 29

Procedurat për Administrimin e Sinjalizimeve dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve

1. Bashkia garanton vendosjen dhe funksionimin e një sistemi të brendshëm të besueshëm, konfidencial dhe të sigurt për pranimin, dokumentimin dhe trajtimin e sinjalizimeve në lidhje me akte apo praktika të mundshme të korrupsionit, abuzimit me detyrën apo shkeljeve të tjera të rënda ligjore, sipas kritereve ligjore në fuqi.
2. Procedurat për administrimin e sinjalizimeve ndërtohen mbi parimin e mbrojtjes së sinjalizuesit, duke ndaluar çdo formë të presionit, hakmarrjes, diskriminimit apo masës ndëshkimore ndaj individëve që raportojnë në mirëbesim shkelje të ligjit.
3. Mbrojtja e sinjalizuesit dhe garantimi i anonimitetit të tij zbatohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe të drejtën për informim publik.

Neni 30

Kodi i Etikës

1. Çdo punonjës i Bashkisë është i detyruar të respektojë Kodin e Etikës.
2. Kodi përcakton standardet e sjelljes etike, ndalimet për përfitime personale, detyrimin për paanshmëri dhe ruajtjen e besimit të publikut ndaj institucionit.
3. Shkeljet e dispozitave të Kodit përbëjnë shkelje disiplinore dhe trajtohen sipas legjislacionit për shërbimin civil dhe Kodit të Punës.

Neni 31

Regjistri i Konfliktit të Interesit dhe Deklarimit të Pasurisë

1. Bashkia mban një regjistër të përditësuar për deklarimin e konfliktit të interesit dhe pasurisë, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
2. Verifikimi dhe mbikëqyrja e këtij regjistri kryhet sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
3. Mospërputhjet apo mospërmbushja e detyrimeve deklaruese i referohen menjëherë institucioneve përgjegjëse për hetimin dhe ndëshkimin e shkeljeve.

KAPITULLI VII

RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

Neni 32

Raportimi Periodik dhe Llogaridhënia Institucionale

1. Bashkia ka detyrimin të sigurojë raportimin periodik mbi realizimin e objektivave strategjike, zbatimin e politikave financiare dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
2. Raportet përgatiten në formë të standardizuar, në përputhje me kuadrin ligjor për menaxhimin financiar publik dhe auditimin e brendshëm, dhe i dorëzohen organeve mbikëqyrëse përkatëse.
3. Për qëllime transparence dhe llogaridhënie publike, përmbledhjet përkatëse të raporteve bëhen të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të Bashkisë.

Neni 33
Garancia e Transparencës dhe Qasja në Informacion

1. Bashkia garanton qasjen e publikut në informacion sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
2. Procedurat për publikimin dhe shpërndarjen e informacionit rregullohen me akte të brendshme dhe duhet të jenë në përputhje me standardet më të mira të administrimit të hapur dhe etik.

Neni 34
Publikimi Periodik i Informacionit

1. Bashkia ka detyrimin të publikojë në mënyrë periodike në faqen e saj zyrtare informacionin e karakterit publik që lidhet me:
 - a) buxhetin dhe raportet financiare vjetore,
 - b) raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm,
 - c) vendimet strategjike të Këshillit Bashkiak,
 - d) çdo dokument tjetër me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Informacioni publikohet në format të kuptueshëm, të përditësuar dhe në përputhje me standardet ligjore.

KAPITULLI VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë dhe publikimit sipas rregullave ligjore.
2. Bashkia ka detyrimin të sigurojë njohjen dhe zbatimin e saj nga të gjitha strukturat përkatëse.